



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>2D/DPK</u> Nr. i fac. Broj. stranica Nr. pages <u>03</u>	Nr. Prot. Bi Prot. <u>01-4910/14</u> Prot. No. Data Datum <u>19.12.2014</u> Day



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 18 (paragrafi 4, 8 dhe 12) të Ligjit nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 19.12.2014 mori:

V E N D I M

I. Ekziston konflikt i interesit “rast për rast” për zyrtarin e lartë Ndue Shabanaj - Anëtar i Kuvendit të Komunës së Klinës, në rastin e miratimit të propozimit për lejimin e ndërtimeve të larta afariste – banesore në afërsi të rreth-rrrotullimit në kuadër të sheshit “Ndue Përlleshi” në Komunën e Klinës.

II. Agjencia do të kërkoj fillimin e Procedurës për Kundërvajtje nga Gjykata kompetente.

III. Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit bëhen publike në ueb faqen zyrtare të Agjencisë.

IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

I. Bazuar në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051 (në tekstin e mëtejme Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit), neni 18 (paragrafi 1 dhe 3), nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi, është inicuar rasti me nr. AKK - 03-3861/14 për zyrtarin e lartë Ndue Shabanaj i cili ushtron funksionin publik të Anëtarit të Kuvendit të Komunës së Klinës.

Pas pranimit të informacionit për dyshimin e ekzistimit të konfliktit të interesit sipas të cilit z. Ndue Shabanaj ka marrë pjesë në mbledhjen e Kuvendit Komunal, të datës 26.09.2014, në të cilën është diskutuar dhe është miratuar propozimi për lejimin e ndërtimeve të larta afariste – banesore në afërsi të rreth-rrrotullimit në kuadër të sheshit “Ndue Përlleshi” në Klinë, ai është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit.

Pas pranimit të kësaj shkrese, z. Shabanaj është takuar me zyrtarët e AKK-së dhe është njoftuar me faktet që posedon Agjencia për këtë rast.

Dyshimi për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik ka qenë sepse njëra prej banesave e cila do të rrënohet, me qëllim të ndërtimit të ndërtesave të larta afariste – banesore, i përket nënës së z. Ndue Shabanaj.

z. Shabanaj ka pranuar se banesa e cila do të rrënohet është në emër të nënës së tij dhe se ka marrë pjesë në mbledhjen në të cilën është diskutuar për këtë çështje. Ai ka deklaruar se kjo nuk paraqet konflikt interesi sepse vota e tij nuk ka qenë përcaktuese në miratimin e propozimit për ndërtimin e ndërtesave të larta në atë pjesë.

Duke pasur parasysh nenin 13 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, z. Shabanaj është dashur të deklaroj konfliktin e interesit në këtë rast dhe të tërhiqet nga kjo mbledhje.

Kjo dispozitë, në piken 1, përcakton se:

1. Çdo zyrtar i lartë gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vet deklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij private lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti të interesit.

Përveç kësaj Ligji PKI në nenin 9 ka paraparë veprimet e ndaluara për zyrtarët e lartë. Pika 1.9 e këtij neni parasheh se zyrtarit të lartë, gjatë ushtrimit të funksionit publik i ndalohet që të ndërmarr veprime të cilat në ndonjë mënyrë do të përshtaten interesit personal të tij apo interesit të personave të afërt apo të besueshëm.

Po ashtu edhe Ligji (Nr. 03/L-040) për Vetqeverisjen Lokale parasheh rastet kur anëtari i kuvendit të komunës duhet të tërhiqet nga mbledhjet e kuvendit komunal. Neni 38 (pika 1 dhe 2) i këtij ligji shprehimisht përcakton:

38.1 Anëtari i kuvendit të komunës apo anëtari i komitetit nuk mund të jetë pjesëmarrës në marrjen e vendimeve dhe në procedurat administrative që kanë të bëjnë me cilëndo çështje në të cilën ai ose ajo, apo ndonjë anëtar i afërt i familjes së tij apo saj, ka interes personal apo material.

38.2 Çdo anëtar duhet t'i shfaqë të gjitha konfliktet e interesit që lindin në çdonjërin prej mbledhjeve në të cilën është prezent. Çdo këshilltar mund të ofrojë informacione për interesat e anëtarit tjetër.

II. Sipas Ligjit për Parandalimin e Konflikti të Interesit, neni 20, pika 1, “Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara me këtë ligj, kur nuk paraqet vepër penale, paraqet kundërvajtje dhe dënohet me gjobë sipas kufijve të përcaktuar në paragrafin 1.1, 1.2 dhe 1.3”.

Sipas Nenit 20 pika 2, “Për shkelje të detyrimeve të përcaktuara me këtë ligj, zyrtarit të lartë publik, udhëheqësit apo drejtuesit të institucionit udhëheqës, përveç dënimit gjykata mund t'i shqiptoj edhe masën mbrojtëse; ndalimi i ushtrimit të funksionit publik në kohëzgjatje prej tre (3) muaj deri në një (1) vit”.

III. Sipas Nenit 18 paragrafi 12, të gjitha Vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit bëhen publike në ueb faqen zyrtare të Agjencisë.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./ znj. (zyrtari ndihmës)

Hasan Preteni
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

